

LAJME BE



BE QENDRA
qershor 2025
BEQ -numër 103/2025

SAMITI I LIDERËVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR



Liderët e gjashtë partnerëve të BE-së nga Ballkani Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia) në Samitin e mbajtur më 30 qershor dhe 1 korrik të këtij viti me Komisioneren Evropiane për Zgjerimin Marta Kos në Shkup konfirmuan vendosmërinë e tyre për të shfrytëzuar mundësitë e Planit të Rritjes për rajonin.

Plani parashikon mbështetje financiare prej gjashtë miliardë eurosh, nga të cilat dy miliardë janë grante dhe katër miliardë janë kredi të buta të ofruara nga BE-ja për reforma dhe investime në fushat e energjetikës, transportit dhe transformimit digjital, me qëllim rritjen e prosperitetit dhe stabilitetit në rajon.

Plani bazohet në 4 shtylla: forcimin e integritit ekonomik në tregun e vetëm të BE-së; forcimin e integritit ekonomik brenda Ballkanit Perëndimor përmes tregut të përbashkët rajonal; përsheptimin e reformave themelore dhe rritjen e ndihmës financiare për të mbështetur reformat.

Fokusi i samitit të Shkupit ishte në reformat kyçe që janë një parakusht për shpërndarjen e mjeteve nga Plani i Rritjes, i cili do t'u sjellë dobi qytetarëve të vendeve- candidate për në BE, përpara anëtarësimit.

Udhëheqësit e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor u zotuan të intensifikojnë përpjekjet për të përmbushur plotësisht agjendat e reformave, ndërsa në lidhje me Planin e Rritjes së Ballkanit Perëndimor, të shfrytëzojnë mundësitë e kësaj iniciative, të cilat përfshijnë përmirësimin e

bashkëpunimit ekonomik rajonal, përmirësimin e aksesit në instrumentet financiare të BE-së, lehtësimin e tregtisë, integrimin e zinxhirëve të furnizimit industrial dhe lehtësimin e tranzicioneve digjitale dhe energjetike për harmonizimin me standardet e BE-së.

Komisionerja e BE-së për zgjerim, Marta Kos, theksoi se pas një viti, 75% e reformave të dakordësuara për vendet e Ballkanit Perëndimor ose janë zbatuar ose janë në proces, dhe theksoi se Plani i Rritjes është çelësi për integrimin e përsheptuar, dhe u bëri thirrje vendeve që të përfundojnë detyrimet e tyre të papaguara sa më shpejt të jetë e mundur.

Në javët në vijim, Komisioni Evropian do të finalizojë vlerësimin e zbatimit të reformave dhe do të vazhdojë procesin e vendimmarrjes për disbursimet e kështit të parë.

Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor u miratua nga Komisioni Evropian më 8 nëntor 2023 dhe synon të integrojë partnerët e BE-së nga Ballkani Perëndimor në Tregun e Përbashkët Evropian, të rrisë bashkëpunimin ekonomik rajonal, të thellojë reformat që lidhen me anëtarësimin dhe të rrisë fondet para anëtarësimit për të përsheptuar konvergjencën socio-ekonomike të rajonit me bllokun.

<https://enlargement.ec.europa.eu>

Përmbajtja e lajmeve:

Samiti i Liderëve të Ballkanit Perëndimor	1
Në fokus të Parlamentit Evropian	2
RREGULLATIVË E RE E BE PËR TRANSPARENCËN POLITIKE	3
PËRFAQËSUESI SPECIAL I BASHKIMIT EVROPIAN PËR TË DREJTAT E NJERIUT	3
Aktivitetet e Kuvendit që lidhen me çështjet evropiane	4
Politika e Përbashkët Bujqësore e BE-se	5
Pakti Evropian për Oqeanet	5
Objektivi i klimës së BE-së për vitin 2040	6
Raporti i gjendjes për dekadën digjitale	6
SAFE - Instrumenti i Kredisë së Mbrojtjes i BE-së	7
Pezullimi i udhëtimit pa viza për vendet e treta	7
Strategjia Digjitale Ndërkombëtare e BE-së	8
VENDET MË TË MIRA EVROPIANE PËR TË JETUAR DHE PUNUAR NË 2025	8
Raporti i Zyrës Evropiane për luftë kundër mashtrimit	9
Strategjia e Re Evropiane e Bioekonomisë	9
Siguria e fëmijëve në internet	10
Marrëveshja Farmaceutike e BE-së	10
Pjesa e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme është ulur	11
Kalendari i BE-së / Korrik 2025	11

NË FOKUS TË PARLAMENTIT EVROPIAN



www.europarl.europa.eu

Sesioni Plenar 16-19 qershor 2025

Sesioni plenar i qershorit i PE-së filloi me një minutë heshtje në kujtim të viktimave të masakrave në shkollat në Austri dhe Francë. Dhuna dhe urrejtja nuk kanë vend në Evropë, as në shkolla, theksoi kryetarja e PE-së.

Eurodeputetët votuan me 488 vota pro për të azhurnohet Marrëveshja për transportin rrugor midis BE-së dhe Ukrainës dhe të vazhdojë deri në fund të vitit 2025, për të lehtësuar lëvizjen e mallrave brenda dhe jashtë vendit. Mbreti i Jordanisë, Madhëria e Tij Abdulla II bin Al-Husein, iu drejtua eurodeputetëve gjatë seancës solemne në Strasburg.

Në rezolutat e miratuara, eurodeputetët mirëpritën qëllimin e Malit të Zi (me 470 vota) për t'u bashkuar me BE-në në vitin 2028 dhe vlerësuan përpjekjet e Moldavisë (me 456 vota) për anëtarësim në BE. Vlerësimi i Parlamentit Evropian për Raportin e Komisionit për Sundimin e së Drejtës për vitin 2024 (i miratuar me 405 vota) dhe zhvillimet e fundit nxjerrin në pah një gamë të gjerë kërcënimesh ndaj vlerave të BE-së në të gjitha vendet -anëtare.

Parlamenti Evropian shënoi 40-vjetorin e zonës Shengen.

Parlamenti Evropian miratoi qëndrimin e draft-ligjit për të përmirësuar kapacitetin e vendeve të BE-së për të luftuar në mënyrë efektive abuzimin seksual të fëmijëve. Propozimi është hartuar për të përshtatur legjislacionin me teknologjitë e reja, p.sh. falsifikimet artificiale por realiste të materialit CSA, dhe për të siguruar që abuzimi dhe shfrytëzimi të mund të ndiqen penalisht pavarësisht nëse ndodhin në internet apo në botën reale.

Në Rezolutën e miratuar me 421 vota, thekson efektin stabilizues të Mekanizmit për rimëkëmbje dhe rezistencë (RRF) në një kohë pasigurie të konsiderueshme ekonomike në Evropë. Eurodeputetët duan që financimi i rimëkëmbjes nga BE-ja të vazhdojë përtej vitit 2026 për të siguruar finalizimin e investimeve kryesore dhe projekteve të mëdha. Parlamenti Evropian miratoi me 386 vota marrëveshje të përkohshme të arritur me Këshillin për paketën për ndihmë

makrofinanciare (MFA) prej 4 miliardë eurosh për Egjiptin.

Rezoluta e miratuar në përgjigje të planit të Komisionit Evropian për Marrëveshje për industri të pastër, e thekson nevojën për të kombinuar veprimet klimatike me konkurrencën industriale. Banka e Dekarbonizimit Industrial dhe Plani i Veprimit për Energji të Përbalueshme janë thelbësore për konkurrencën dhe qëndrueshmërinë e industrisë evropiane, theksuan eurodeputetët. Parlamenti Evropian miratoi rezoluta për të drejtat e njeriut mbi Gjeorgjinë, Iranin dhe Malin.

Eurodeputetët miratuan propozime për modernizimin e rrjetit elektrik të BE-së, rritjen e qëndrueshmërisë, integrimin e burimeve të energjisë së ripërtëritshme dhe thjeshtimin e lejeve për të përmbushur objektivat e energjisë të BE-së. Ata theksuan rëndësinë e planifikimit evropian për të lidhur kufijtë, sektorët dhe rajonet. Burimet e energjisë së ripërtëritshme duhet të integrohen më mirë në rrjetet e energjisë elektrike dhe nevojiten më shumë ndërlidhje ndërkufitare.

RREGULLATIVË E RE E BE PËR TRANSPARENCËN POLITIKE

Këshilli i Bashkimit Evropian dhe Parlamenti Evropian më 17 qershor 2025 arritën marrëveshje mbi rishikimin e Rregullativës për statutin dhe financimin e partive politike dhe fondacioneve evropiane. Ky rishikim ishte pjesë e "Paketës së Demokracisë dhe Integritetit për Zgjedhjet Evropiane" më të gjerë, të miratuar nga Komisioni Evropian më 25 nëntor 2021.

Qëllimi i rregullativës së rishikuar është të ofrojë rregulla të qarta dhe të rrepta për financimin e partive politike dhe fondacioneve evropiane, me qëllim parandalimin e rreziqeve të ndërhyrjeve të huaja dhe manipulimit politik. Rishikimi zvogëlon barrën administrative për subjektet politike, duke lehtësuar punën e tyre dhe duke kontribuar në një zbatim më efikas të legjislacionit evropian. Në mënyrë plotësuese forcohet dukshmëria dhe aksesit para qytetarëve, me çka rritet besimi i përgjithshëm në proceset demokratike të BE-së.

Ndryshimet kryesore përfshijnë mekanizma të rinj për të rritur transparencën e burimeve të financimit, kontroll më të mirë të mjeteve që mund të burojnë nga burime jodemokratike dhe të huaja, si dhe masa për të ruajtur pajtueshmërinë me vlerat dhe parimet themelore të BE-së. Forcohen kushtet për marrjen e statusit të një partie politike ose fondacioni evropian, me qëllim parandalimin e abuzimeve dhe rritjen e legjitimitetit të këtyre subjekteve. Me këtë kuadër rregullator, BE-ja demonstroi vendosmërinë e saj për të krijuar një mjedis politik të sigurt, transparent dhe demokratikisht të përgjegjshëm, bazuar në parimet e drejtësisë, përgjegjshmërisë dhe përfshirjes.



<https://polish-presidency.consilium.europa.eu/en/news>

PËRFAQËSUESI SPECIAL I BASHKIMIT EVROPIAN PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Këshilli i Bashkimit Evropian ka emëruar ish-ministren holandeze Kajsa Ollongren për përfaqësuese speciale e BE-së për të Drejtat e Njeriut (EUSR).

Kajsa Ollongren është ish-politikane holandeze me përvojë të konsiderueshme në nivel nacional, në pozicione të ndryshme, duke përfshirë ministren e Punëve të Brendshme, zëvendëskryeministren e Holandës dhe ministren e Mbrojtjes nga janari 2022 deri në korrik 2024.

Përfaqësuesja e re Speciale e BE-së do të punojë në fushën e zbatimit të politikës së të drejtave të njeriut të BE-së, promovimin e respektit për të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe mbështetjen e drejtësisë penale ndërkombëtare, si dhe forcimin e zërit evropian përmes dialogëve për të drejtat e njeriut me qeveritë e vendeve të treta, organizatat ndërkombëtare dhe rajonale, shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë përkatës.

Përfaqësuesi Special do të punojë ngushtë me Shërbimin Evropian të Veprimit të Jashtëm dhe institucionet e BE-së për të siguruar efektivitetin dhe dukshmërinë e politikës së të drejtave të njeriut të BE-së në veprimin e jashtëm.

Përfaqësuesit Specialë të BE-së promovojnë politikën dhe interesat e Bashkimit në rajone dhe vende specifike, si dhe në çështje me rëndësi të veçantë për BE-në.

Përfaqësuesit e parë Specialë të BE-së u emëruan në vitin 1996 dhe aktualisht ka 11 të tillë, të cilët mbështesin punën e Përfaqësueses së Lartë të BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, Kaia Kallas.



<https://www.euronews.rs>

AKTIVITETET E KUVENDIT TË LIDHURA ME ÇËSHTJET EVROPIANE



Kryetari i Kuvendit, Afrim Gashi, më 30 qershor 2025 realizoi takim me Drejtoreshën e Shërbimit Evropian për Punë të Jashtme të BE-së, Zuzana Mihalcova Sutijakova. Në takim u shkëmbyen mendime mbi çështjet aktuale dhe nivelin e reformave të zbatuara që lidhen me anëtarësimin e vendit tonë në Bashkimin Evropian. Në takim, Gashi shprehu gatishmërinë për të zbatuar kushtin e fundit për vazhdimin e procesit të negociatave, duke siguruar njëfarë parashikueshmërie për fazat e mëtejshme në pajtim me kriteret e Kopenhagenit.

www.sobranie.mk

Kryetari i Komisionit për Çështje Evropiane, Antonio Milloshoski, së bashku me anëtarët dhe zëvendësanëtarët e Komisionit, u takuan me ministren për Çështje Evropiane të Danimarkës, Mari Bjer, më 18 qershor 2025. Tema kryesore e takimit ishin zhvillimet aktuale në skenën globale dhe procesi i integritetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian, gjatë të cilit u shkëmbyen mendime mbi sfidat dhe perspektivat me të cilat përballlet vendi ynë dhe Evropa në këtë kontekst.



Më 9 qershor 2025, anëtarët e Komitetit për Çështje Evropiane (KÇE) u takuan me Ambasadorin e Francës, Kristof Le Rigole. Në takim u shkëmbyen mendime mbi procesin e integritetit evropian të Maqedonisë së Veriut, me theks në mbështetjen franceze. Zëvendëskryetari i KÇE, Igor Zdravkovski, theksoi se qëllimi i anëtarësimit të plotë të vendit tonë në BE përfaqëson veprim real për të përmbushur reformat e nevojshme.



Deputetja Mimoza Musa, anëtare e Komisionit për Çështje Evropiane, mori pjesë në Konferencën e 73-të të Komisioneve për Çështje Evropiane të Parlaamenteve të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian (KOCAK), e cila u mbajt nga 8 deri më 10 qershor 2025 në Varshavë, Republika e Polonisë. Deputetja Mimoza Musa, në fjalimin e saj kryesor në sesionin e dytë të Konferencës, theksoi se vendi ynë po punon aktivisht në tranzicionin e gjelbër, digjitalizimin, zhvillimin ekonomik dhe luftën kundër korrupsionit. Ajo theksoi rëndësinë e vazhdimin të politikës së zgjerimit në bazë të meritave.

POLITIKA E PËRBASHKËT BUJQËSORE E BE-SË

Bujqit në të gjithë Bashkimin Evropian përballen me detyrime të shumta administrative që rëndojnë ndjeshëm punën e tyre të përditshme dhe përfaqësojnë një barrë të konsiderueshme financiare për bujqit dhe administratat nacionale. Për të lehtësuar situatën, Komisioni Evropian ka propozuar ndryshime në rregullat e Politikës së Përbashkët Bujqësore me qëllim uljen e barrës rregullatore dhe inkurajimin e konkurrueshmërisë. Ndër masat e propozuara janë një rritje e pragut vjetor për pagesat me normë fikse për fermerët e vegjël nga 1,250 në 2,500 euro dhe përjashtim nga disa kërkesa ekologjike. Fermat organike të certifikuara do të konsiderohen automatikisht në përputhje me standarde të caktuara mjedisore dhe kontrollet e kontrollit do të kryhen një herë në vit me mbështetjen e teknologjisë satelitore.



Në fushën e menaxhimit të krizave, janë planifikuar instrumente të reja për mbështetje financiare në rast të fatkeqësive natyrore dhe sëmundjeve, dhe vendet -anëtare do të kenë fleksibilitet më të madh në përshtatjen e planeve të tyre që rrjedhin nga Politika e Përbashkët Bujqësore. Përveç kësaj, parashikohet mbështetje financiare deri në 50,000 € për zhvillimin e fermave të vogla dhe digjitalizimin e proceseve administrative përmes sistemeve të të dhënave të vetme. Kjo paketë masash është një vazhdim i reformave të nisura në vitin 2024 dhe një pjesë e rëndësishme e vizionit të ri të BE-së për bujqësi të qëndrueshme dhe siguri ushqimore, të prezantuar në shkurt 2025. Procesi do të vazhdojë me iniciativa të reja për të thjeshtuar më tej legjislacionin.

<https://commission.europa.eu>

PAKTI EVROPIAN PËR OQEANET

Komisioni Evropian miratoi një Pakt Evropian për Oqeanin më 11 qershor, i cili do të ndihmojë në promovimin e ekonomisë gri të lulëzuar dhe do të mbështesë mirëqenien e njerëzve që jetojnë në zonat bregdetare.

Në Samitin e Oqeanit të KB-së të vitit 2025, kryetarja e Komisionit Evropian Ursula fon der Lajen njoftoi një investim prej 1 miliard eurosh për të mbështetur ruajtjen e oqeanëve, shkencën dhe peshkimin e qëndrueshëm. Fushat prioritare për veprim janë: mbrojtja dhe rivendosja e shëndetit të oqeanëve, rritja e konkurrueshmërisë së ekonomisë së qëndrueshme gri të BE-së, mbështetja e komuniteteve bregdetare dhe ishullore dhe rajoneve më të largëta, forcimi i bashkëpunimit të rojeve bregdetare të BE-së dhe sigurisë së kufijve detarë, avancimi i kërkimit, njohurive, aftësi dhe inovacionit të oqeanit, si dhe forcimi i diplomacisë oqeanike të BE-së dhe qeverisjes ndërkombëtare të oqeanëve.



Komisioni Evropian është zotuar të përgjysmojë ndotjen nga plastika dhe lëndët ushqyese dhe të rivendosë 20% të ekosistemeve detare të Evropës deri në vitin 2030.

Pakti Evropian i Oqeanit do të plotësohet me legjislacionin përkatës deri në vitin 2027, i cili do të ndihmojë në sigurimin e zbatimit të prioritetëve të pazgjidhura të Paktit.

<https://commission.europa.eu>

OBJEKTIVI KLIMATIK I BE-SË PËR VITIN 2040



Komisioni Evropian paraqiti më 2 korrik 2025 një propozim për një objektiv të ardhshëm klimatik që synon një ulje prej 90% të emisioneve të gazrave serrë krahasuar me nivelet e vitit 1990 deri në vitin 2040. Objektivi i vitit 2040 është një hallkë kyçe që mungon në rrugën e dekarbonizimit të BE-së dhe objektivin e saj të zero emisioneve.

Objektivi i propozuar i Komisionit përfshin një kuotë prej 3% të objektivit sipas Nenit 6 të Marrëveshjes së Parisit. Shoqata ndërkombëtare e tregtimit të emetimeve IETA e mirëpriti këtë veprim pragmatik të Komisionit për të lidhur Sistemin e Tregtimit të Emetimeve të BE-së (EU ETS) me tregun më të gjerë ndërkombëtar të karbonit.

Politikëbërësit evropianë kanë qenë prej kohësh skeptikë në lidhje me lejimin e krediteve ndërkombëtare në tregjet e karbonit të BE-së, shpesh duke përmendur "përvojë negative".

Kreditë ndërkombëtare sot janë të ndryshme nga 15 vjet më parë, neni 6 tani ofron një kornizë globale për bashkëpunimin ndërkombëtar në tregun e karbonit dhe Mekanizmi i ri i Kreditit të Marrëveshjes së Parisit (PACM) ofron rregulla të standardizuara dhe qeverisje më të mirë.

Ruajtja e stabilitetit të tregut dhe funksionimi efikas i Sistemit të Tregtimit të Emetimeve të BE-së duhet të mbetet një përparësi. Shtetet Anëtare dhe Parlamenti Evropian thirren të mbështesin përmirësimin e fleksibilitetit dhe rolit të krediteve të Nenit 6 në Paketën e Klimës 2040. Paketa legislative pritet verën e ardhshme, e ndjekur nga një periudhë negociatash me bashkë ligjvënësit. Megjithatë, propozimi për një objektiv 2040 meriton të miratohet, për të siguruar stabilitet dhe para shikueshmëri afatgjatë.

<https://www.euractiv.com>

RAPORT VJETOR PËR DEKADËN DIGJITALE



Komisioni Evropian publikoi më 16 qershor 2025 Raportin Vjetor mbi Gjendjen e Dekadës Digjitale, duke vlerësuar progresin e Bashkimit Evropian drejt arritjes së objektivave të përcaktuara në Politikën Digjitale për vitin 2030. Raporti është një vlerësim gjithëpërfshirës i gjendjes së transformimit dixhital në Bashkim, me gjetjet kryesore që tregojnë se Bashkimi përballet me zbatim të ngadaltë të infrastrukturave digjitale (siç janë rrjetet me fibra optike dhe rrjetet e pavarura 5G), gjë që kufizon shpejtësinë dhe cilësinë e lidhjes digjitale. Përshtatja e teknologjive të përparuara si inteligjenca artificiale, retë dhe të dhënat e mëdha po rritet, por jo aq shpejt sa për të arritur qëllimet ambicioze të konkurrencës dhe inovacionit.

Sa i përket aftësive digjitale, 55.6% e qytetarëve të BE-së kanë një nivel bazë të kompetencave digjitale. Mungesa e specialistëve të TIK-ut, veçanërisht me njohuri të avancuara, është e theksuar dhe shoqërohet nga një çekuilibër i konsiderueshëm gjinor, i cili kufizon seriozisht zhvillimin në fushat e sigurisë kibernetike dhe zbatimin e inteligjencës artificiale.

Ekziston një trend pozitiv në digjitalizimin e shërbimeve publike, megjithatë, disa sisteme digjitale qeveritare vazhdojnë të mbështeten në teknologji dhe shërbime nga burime jo-vendase, gjë që përbën një rrezik për sovranitetin digjital të BE-së.

Në Raport theksohet se tregjet digjitale të fragmentuara, rregulloret komplekse dhe varësia strategjike teknologjike janë sfida strukturore që duhen adresuar.

Me veprime të forta dhe të koordinuara digjitale, BE-ja mund të rrisë ndjeshëm PBB-në, qëndrueshmërinë ekonomike dhe kohezionin social. Hapi tjetër - Shtetet anëtare do të shqyrtojnë rekomandimet e Komisionit dhe do të punojnë së bashku për të përcaktuar hapat e ardhshëm për të përmbushur objektivat e transformimit dixhital deri në vitin 2030.

<https://commission.europa.eu>

INSTRUMENTI I KREDISË SË MBROJTJES I BE-SË - SAFE

Këshilli i Bashkimit Evropian miratoi Instrumentin "Veprimi për Sigurinë për Evropën" (SAFE) më 25 maj të këtij viti, si një element kyç i strategjisë së përgjithshme të BE-së për gatishmërinë mbrojtëse - Plani/Gatishmëria për Evropën ReArm 2030. Ky instrument financiar do të vërë në dispozicion 150 miliardë euro shtesë në tregjet e kapitalit, me qëllim rritjen e ndjeshme të investimeve në teknologjitë dhe aftësitë kritike të mbrojtjes (sistemet e mbrojtjes nga raketat ajrore, dronët dhe përforcuesit strategjikë).

Kryetarja e Komisionit Evropian, Ursula von der Lajen, e vlerësoi marrëveshjen SAFE si një hap historik dhe të nevojshëm për të forcuar sigurinë evropiane dhe theksoi se "Evropa duhet të marrë përgjegjësinë për mbrojtjen e saj, SAFE është një investim në qëndrueshmëri, konkurrencë teknologjike dhe krijimin e një tregu vërtet të përbashkët evropian të mbrojtjes. Evropa po ecën përpara - me qëllim, me unitet dhe me një udhërrëfyes të qartë drejt Përgatitjes 2030".

Fondet do të mbledhen përmes tregjeve të kapitalit dhe do të shpërndahen sipas kërkesës për Shtetet Anëtare të interesuara në bazë të planeve kombëtare për investime në industrinë evropiane të mbrojtjes.

Ky instrument ambicioz mbrojtës synon të rrisë aftësinë mbrojtëse evropiane, duke forcuar njëkohësisht konkurrueshmërinë dhe ndërveprimin e bazës industriale evropiane të mbrojtjes. Shtetet Anëtare kanë deri në 6 muaj nga hyrja në fuqi e Rregullores për të paraqitur planet e tyre kombëtare, të cilat Komisioni do t'i vlerësojë dhe, në bazë të propozimit të tij, Këshilli pritet të miratojë një vendim zbatues, i cili do të përfshijë vëllimin e kredisë dhe para financimin që mund të arrijë deri në 15% të kredisë.



<https://ec.europa.eu/commission>

PEZULLIMI I UDHËTIMIT PA VIZA NË VENDET E TRETË

Këshilli i Bashkimit Evropian dhe Parlamenti Evropian arritën një marrëveshje të përkohshme më 17 qershor 2025 për të përditësuar mekanizmin që lejon pezullimin e udhëtimit pa viza për qytetarët e vendeve të treta që nuk i nënshtrohen kërkesave për vizë për hyrje në zonën Shengen. Qëllimi i ndryshimit legjislativ është të forcojë kapacitetin e BE-së për t'u mbrojtur kundër abuzimit me vizat dhe për të mbrojtur interesat e sigurisë, politike dhe ekonomike të Bashkimit.

Pezullimi do të zbatohet aty ku ka indikacione serioze të migrimit të parregullt, abuzimit të skemave të shtetësisë, kërcënimeve hibride ose ndërprerjeve në marrëdhëniet e jashtme nga vendet e treta, veçanërisht në lidhje me të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit.

Rregullat e reja përfshijnë një prag prej 30% rritjeje të refuzimeve të hyrjes ose tejkallimeve të afatit të qëndrimit, si dhe një shkallë të ulët të njohjes së azilit (nën 20%) që mund të shkaktojë pezullim. Kohëzgjatja e pezullimit të përkohshëm do të rritet nga 9 në 12 muaj, me mundësinë e zgjatjes në 24 muaj. Nëse vendi i tretë nuk bashkëpunon, BE-ja do të ketë mundësinë e heqjes së përhershme të regjimit pa viza. E reja është se në vend që të sanksionohet e gjithë popullsia, masat mund të synojnë vetëm vendimmarrësit - zyrtarët qeveritarë dhe diplomatët - kur të vërtetohet se ata janë drejtpërdrejt përgjegjës për shkeljet. Hapi tjetër është miratimi zyrtar i marrëveshjes nga institucionet kompetente të BE-së.



<https://polish-presidency.consilium.europa.eu>

STRATEGJIA NDËRKOMBËTARE DIGJITALE E BE-SË



Strategjia digjitale ndërkombëtare e BE-së tregon se Bashkimi është një partner i qëndrueshëm dhe i besueshëm, i hapur për bashkëpunim digjital me aleatët dhe partnerët.

Strategjia konfirmon angazhimin e BE-së për të ndërtuar një rend digjital global të bazuar në rregulla, në përputhje me vlerat e saj themelore.

Strategjia synon të zgjerojë partneritetet ndërkombëtare, ofertën e biznesit teknologjik të BE-së për të mbështetur tranzicionin digjital të vendeve partnere dhe për të forcuar qeverisjen digjitale globale, duke promovuar një rend digjital global.

Bashkimi Evropian ka një bashkëpunim të gjatë mbi prioritetet digjitale me vendet anëmbanë botës, në veçanti përmes Këshillave të Tregtisë dhe Teknologjisë, partneriteteve digjitale dhe

marrëveshjeve të tregtisë digjitale. Bashkëpunimi me vendet partnere do të përqendrohet në disa prioritetet, të tilla si infrastruktura digjitale e sigurt dhe e besueshme, teknologjitë në zhvillim (inteligjenca artificiale, 5G/6G), siguria kibernetike, qeverisja digjitale dhe të tjera.

Hapat e mëtejshëm - Komisioni Evropian dhe Përfaqësuesi i Lartë do të paraqesin propozimet në një sërë ngjarjesh menjëherë pas miratimit të tyre, me qëllim që të fillojnë zbatimin më shpejt të veprimeve të përcaktuara në komunikimin e përbashkët.

<https://ec.europa.eu/commission>

VENDET MË TË MIRA EVROPIANE PËR TË JETUAR DHE PUNUAR NË 2025



Të dhënat e marra nëpërmjet Eurostat, OECD, Organizatës Ndërkombëtare të Punës dhe Institutit Evropian për Barazi Gjinore u morën nga një anketë e kompanisë së lojërave të fatit online CasinooftheKings për të analizuar treguesit ekonomikë dhe socialë që lidhen me gratë në 16 vende. Dhjetë tregues kryesorë përfshijnë hendekun gjinor në paga, pronësinë e llogarive bankare dhe pjesën e sipërmarrëseve femra.

Një studim i ri ka zbuluar se vendet nordike vazhdojnë të dominojnë renditjen globale për barazinë gjinore në vendin e punës, duke demonstruar se politikat gjithëpërfshirëse sociale mund të krijojnë mjedise për gratë që të përparojnë profesionalisht. Danimarka, Finlanda dhe Suedia janë tre vendet e para nga 16 vendet evropiane të renditura për kushtet e punës dhe të jetesës

së grave në vitin 2025. Danimarka kryeson listën, duke ofruar lejen më të gjatë të lehonisë me 18 muaj dhe një indeks të lartë të barazisë gjinore prej 0.78, me hendekun më të vogël gjinor në pozicionet drejtuese me 27.9%. Në vendin e dytë është Finlanda, e cila ka më shumë sipërmarrëse femra sesa Danimarka, dhe hendekun më të vogël të punësimit në renditje me 1.5%. Ajo mbetet prapa në aspektin e disponueshmërisë së lejes së lehonisë dhe hendekut gjinor në paga. Suedia renditet e treta në listën e vendeve më të mira për gratë për të punuar dhe jetuar në vitin 2025. Vendi ka hendekun më të madh gjinor në pozicionet drejtuese në 10 vendet e para, me 42.3%, por spikat me një hendek të vogël në paga prej 7.3% dhe 12 muaj leje lehonie. Italia dhe Greqia janë në fund të listës, me rezultate prej 52 dhe 56 në standardet e jetesës.

<https://www.euronews.com>

RAPORTI I ZYRËS EUROPIANE PËR LUFTË KUNDËR MASHTRIMIT

Zyra Evropiane për luftë kundër mashtrimit (OLAF) në raportin e saj vjetor të publikuar më 16 qershor 2025 rekomandon rikuperimin e më shumë se 870 milionë eurove në fondet e BE-së të keqpërdorura.

Hetuesit e OLAF-it kanë parandaluar mbi 40 milionë euro në fondet e BE-së të keqpërdorura, duke forcuar rolin e OLAF-it si mbrojtës i buxhetit të BE-së.

Duke shënuar 25-vjetorin e tij, raporti thekson angazhimin e OLAF-it për të mbrojtur interesat financiare të BE-së dhe konfirmon rolin udhëheqës të OLAF-it në luftën kundër mashtrimit.

Në vitin 2024, OLAF mbylli 246 hetime dhe bëri 301 rekomandime për veprime të mëtejshme autoriteteve kompetente nacionale dhe të BE-së. Nga mashtrimet komplekse financiare dhe tregtia e paligjshme ndërkufitare deri te veprat penale doganore, mashtrimet mjedisore dhe parandalimi i shmangies së sanksioneve, OLAF po demonstroi rëndësinë dhe përshtatshmërinë e saj përballë sfidave në rritje.

Në tre vitet e fundit, hetimet e OLAF-it kanë çuar në kthimin e 4.5 miliardë eurove dhe parandalimin e mbi 800 milionë eurove në shpenzime të parregullta. Në funksionin e saj të pavarur hetimor, Zyra mund të hetojë çështje që lidhen me mashtrimin, korrupsionin dhe vepra të tjera penale që prekin interesat financiare të BE-së.



<https://anti-fraud.ec.europa.eu>

STRATEGJIA E RE EVROPIANE PËR BIOEKONOMINË

Komisioni Evropian po përgatit një strategji të re për bioekominë, e cila është planifikuar të miratohet deri në fund të vitit 2025, me qëllim nxitjen e inovacionit dhe forcimin e bioekonomisë evropiane.

Strategjia pritet të nxjerrë në pah masat që do të ndihmojnë në sjelljen e inovacionit në tregun e bioekonomisë, duke krijuar mundësi të reja për vende pune të gjelbra dhe rritje të qëndrueshme ekonomike.


Një fokus kryesor i strategjisë do të jetë përmirësimi i qarkullueshmërisë dhe qëndrueshmërisë, duke mbështetur përpjekjet më të gjera të BE-së për dekarbonizim. Ajo do të krijojë kushtet e nevojshme kornizë për të mbështetur bizneset e reja, sipërmarrësit dhe modelet e reja të biznesit në bioekonomi.

Duke u përafëruar me iniciativat kryesore të BE-së, të tilla si Busulla e Konkurrueshmërisë dhe Marrëveshja e Industrisë së Pastër, strategjia do të shfrytëzojë potencialin e bioekonomisë për të mbështetur bizneset evropiane dhe për të çuar përpara objektivat mjedisore, klimatike dhe të konkurrueshmërisë të BE-së.



<https://www.euractiv.com>

SIGURIA E FËMIJËVE NË INTERNET



Fëmijët sot nuk janë të sigurt në internet, por ndalimi i tyre nga mediat sociale nuk është zgjidhje dhe është një qasje joefektive për t'iu përgjigjur kërcënimeve dhe dëmeve në rritje me të cilat përballen ata në internet. Rreziqet me të cilat përballen fëmijët në internet po rriten me një ritëm alarmues, me rreth 63 milionë imazhe dhe video të materialeve të abuzimit seksual me fëmijë të zbuluara në internet në vitin 2024. Numri i fëmijëve që joshen me përmbajtje për të rritur në internet është rritur me mbi 300% vitet e fundit. Si përgjigje, disa kreator të politikës dhe liderë të teknologjisë në BE po mblidhen rreth një propozimi: ndalimi i plotë i përdorimit të mediave sociale për fëmijët nën një moshë të caktuar. Kjo mund të duket si një politikë e lehtë dhe bindëse për t'u shpjeguar votuesve, por e thjeshtëzon shumë një problem shumë më kompleks. Shumë ekspertë të mbrojtjes së fëmijëve në internet janë seriozisht të shqetësuar për këtë trend,

sepse ndalimet nuk funksionojnë dhe madje mund të përhapin dëm, pasi fëmijët kanë më pak gjasa të raportojnë abuzim ose dëm në internet.

Ajo që u nevojitet fëmijëve nuk janë zgjidhje të thjeshta, por standarde sigurie të zbatueshme për platformat, të informuara nga realiteti se si fëmijët e përdorin teknologjinë.

Me zbatimin e duhur të Aktit të Shërbimeve Digjitale, siguria e fëmijëve pritet gjithashtu të përmirësohet. Rregullorja e abuzimit seksual të fëmijëve, e propozuar nga Komisioni Evropian më shumë se tre vjet më parë, do t'i mbante kompanitë përgjegjëse për mundësimin e përhapjes së abuzimit seksual të fëmijëve në internet. Por negociatat midis vendeve të BE-së aktualisht kanë ngecur.

<https://www.euractiv.com>

MARRËVESHJA FARMACEUTIKE E BE-SË



Pas marrëveshjes mbi paketën farmaceutike të arritur në Këshill më 4 qershor të këtij viti, qeveritë e Suedisë dhe Danimarkës mirëpritën propozimin për të ruajtur periudhën aktuale tetëvjeçare për mbrojtjen e të dhënave për ilaçet e reja.

Të dy vendet e kishin bllokuar më parë marrëveshjen dhe pas dy vitesh negociatash u arrit një marrëveshje midis shteteve anëtare të BE-së.

Komisioni Evropian fillimisht propozoi një reduktim në gjashtë vjet, ndërsa Parlamenti Evropian propozoi një periudhë shtatëvjeçare dhe gjashtëmujore për mbrojtjen e të dhënave për ilaçet e reja.

Kompanitë e mëdha farmaceutike në Danimarkë shpeshojnë që rezultati të konfirmohet, veçanërisht pasi negociatat do të zhvillohen nën kryesisë daneze të BE-

së nga 1 korriku i këtij viti. Konfederata e Industrisë Daneze - shoqata më e madhe e bizneseve private dhe punëdhënësve në Danimarkë - shprehu pakënaqësi, duke thënë se marrëveshja do të zvogëlonte mundësitë për kompanitë farmaceutike për të zhvilluar barna të reja. Për shembull, një vit do të jepet nëse ilaçi adreson një nevojë të paplotësuar mjekësore kur kompania paraqet kërkesën e saj për autorizim.


<https://www.euractiv.com>

PJESA E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA BURIMET E RIPËRTËRITSHME ËSHTË ULUR

Në tremujorin e parë të vitit 2025, 42.5% e prodhimit neto të energjisë elektrike në BE erdhi nga burimet e energjisë së ripërtëritshme. Krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2024, kjo përfaqëson një rënie prej 4.3%.

Midis vendeve të BE-së, në tremujorin e parë të vitit 2025, Danimarka kishte pjesën më të lartë të burimeve të energjisë së rinovueshme në prodhimin neto të energjisë elektrike me 88.5%, e ndjekur nga Portugalia (86.6%) dhe Kroacia (77.3%). Pjesët më të ulëta të burimeve të energjisë së rinovueshme ishin në Republikën Çeke (13.4%), Maltë (14.4%) dhe Sllovaki (15.1%).

Në 19 shtete anëtare të BE-së, pjesa e burimeve të energjisë së rinovueshme në prodhimin neto të energjisë elektrike u ul në tremujorin e parë të vitit 2025 krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2024. Kjo u shoqërua me një rënie në prodhimin e energjisë hidroelektrike dhe të erës. Rënitë më të mëdha u regjistruan në Greqi (-12.4 pikë përqindjeje), Lituani (-12.0 p.p.) dhe Sllovaki (-10.6 p.p.). Pjesa më e madhe e energjisë elektrike të gjeneruar nga burimet e rinovueshme në tremujorin e parë të vitit 2025 vjen nga energjia e erës (42.5%), energjia hidroelektrike (29.2%) dhe energjia diellore (18.1%), lëndët djegëse të rinovueshme të djegshme (9.8%) dhe energjia gjeotermale (0.5%).



<https://ec.europa.eu/eurostat>

LIGJET E MIRATUARA ME FLAMUR EVROPIAN NË PERIU DHËN MAJ-QERSHOR 2025

- *Ligji për Energjetikën,
- *Ligji për vënie në përdorim të pajisjeve teknike për Transport,
- *Ligji për komunikime elektronike,
- *Ligji për sigurinë e rrjetit dhe sistemeve të informacionit,
- *Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për dokumentet elektronike, identifikimin elektronik dhe shërbimet e besueshme,
- *Ligji për materialin arkivor dhe veprimtarinë arkivore.



KALENDARI BE / korrik 2025

1. Kryesia Daneze me Këshillin e BE-së, 1/7/2025 - 31/12/2025;
2. Takimi i Këshillit për Punë të Jashtme, 14 dhe 15/7/2025, Bruksel;
3. Takimi i Këshillit për Punë të Përgjithshme, 18/7/2025, Bruksel;
4. Sesioni Plenar i Parlamentit Evropian, 7-10/7/2025, Strasburg.

Linqe të dobishme për publikimet elektronike të BE-së:

<https://publications.europa.eu/en/home>

<https://europa.eu/european-union/documents-publications>

<http://www.europarl.europa.eu/visiting/en/brussels/parlamentarium>

European Union Newsroom

europa.eu

EUROPA > Newsroom > Calendar

Home Highlights Press releases **Calendar** Audiovisual Press contacts Press facilities Subscription services About the EU

CALENDAR

Translate this page

BROWSE FORTHCOMING EVENTS

By topic
Choose a topic

By organiser
Choose an organiser

By type
Choose a type

BY MONTH

Mon	Tue	Wed	Thu	Fri	Sat	Sun
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30
31						



KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

QENDRA BE E KUVENDIT

Adresa: „11 Октомври“ nr.10, Shkup, 1000

Telefon: +389 2 3 11 22 55 lokal 414 dhe 277

E-posta: nsei@sobranie.mk

Zyra 019

www.sobranie.mk

Në Parlament u zbatua Projekti IPA për "Ndihmë Teknike për Parlamentin" në periudhën nga janari 2011 deri në qershor 2012, objektivi i përgjithshëm i të cilit ishte forcimi i kapacitetit institucional të Kuvendit dhe në këtë mënyrë përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies së tij ndaj qytetarëve.

Në kuadër të projektit IPA, u ofrua ndihmë financiare dhe nga ekspertë për krijimin e një Qendre të BE-së në Kuvend.

Qëllimi i krijimit të Qendrës së BE-së është t'u ofrojë Anëtarëve të Kuvendit dhe Shërbimit akses më të mirë në informacion në lidhje me çështjet e BE-së.

Qendra e BE-së është në aspektin organizativ brenda Sektorit për Mbështetje të Këshillit Nacional për Integrimin Evropian dhe Monitorimin e Integritimit Evropian.

Qendra e BE-së ka një bibliotekë me libra dhe botime nga fusha të ndryshme të politikave evropiane.

